



## BASHKIA LIBRAZH'D

---

### BASHKIA LIBRAZH'D SHPALL:

#### **1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:**

- ***Menaxher projekti***

Bashkia Librazhd është shpallur fituese në thirrjen IPA 2018 - EU for socio-economic development (as alternative to drugs cultivation and trafficking) me projektin “No Drugs! Food Hub – A sustainable development alternative for youth and communities in Librazhd”, Kohëzgjatja e projektit do të jetë 28 muaj, ku implementimi fillon në muajin Tetor.

Menaxheri i projektit do të ketë këto detyra dhe përgjegjësi:

- Sigurimi në kohë, në fushëveprimin dhe zbatimin e buxhetit të veprimit të propozuar në projekt;
- Mban marrëdhënie me donatorin dhe siguron që të gjitha kërkesat e donatorit të përmbushen në kohë dhe me saktësi;
- Harton dhe paraqet raporte të rregullta për donatorin, si raporte financiare ashtu dhe narrative;
- Mban marrëdhënie me mediat dhe siguron arritjen e dukshmërisë së projektit;
- Siguron që shpenzimet buxhetore të mbahen në mënyrë të rregulltë;
- Siguron që të gjitha blerjet janë bërë sic duhet, sipas procedurave të prokurimit;
- Siguron që planet dhe raportet mujore janë në rregull dhe mban koordinim të ngusht me koordinatorin e projektit, si dhe me bashke aplikantin World Vision;
- Menaxheri i projektit do të përfshihet drejtpërdrejt në zbatim vecanërisht në linjat për ndërtim, konsulencë për planin e biznesit, dukshmërinë dhe certifikimin e produkteve.

Në projekt janë cilësuar të gjitha detyrat dhe përgjegjësit që do të ketë menaxheri i projektit.

Të interesuarit për pozicionin e punës duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Përvojë dhe aftësi të mëparshme në kryerjen e një menaxhimi projekti. Përvoja me skemat e dhënies së granteve të BE-së do të konsiderohet si përparësi;
- Përvojë në përgatitjen dhe/ose zbatimin e projekteve të financuara nga fondet publike, në nivel vendor;
- Njohja e bazës ligjore, dokumenteve strategjike, politikave në fushën e dhënies së fondeve EU;
- Njohja e parimeve të Ciklit të Menaxhimit të Projekteve (PCM);
- Njohja e gjuhës shqipe dhe angleze në nivel të lartë në të folur dhe të shkruar .

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim në adresat: [info@bashkialibrazhd.gov.al](mailto:info@bashkialibrazhd.gov.al), [manjolaomeri@bashkialibrazhd.gov.al](mailto:manjolaomeri@bashkialibrazhd.gov.al) ose pranë zyrës së protokollit, Bashkia Librazhd.

- CV (duke specifikuar përvojën e mëparshme në fushat e sipërpërmendura);
- Letër Motivimi

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është data **13 Tetor 2021**

Për informacion të mëtejshëm, ju lutem mos hezitoni të kontaktoni në adresat:

[info@bashkialibrazhd.gov.al](mailto:info@bashkialibrazhd.gov.al) ; [manjolaomeri@bashkialibrazhd.gov.al](mailto:manjolaomeri@bashkialibrazhd.gov.al)